



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I KONKURRENCËS  
DREJTORIA E BURIMEVE NJEREZORE, SHERBIMEVE DHE  
DOKUMENTACIONIT**

**Njoftim per tre vende te lira pune**

Në zbatim të ligjit nr. 8549, datë 11.11.1999 "Statusi i nëpunësit civil", neni 13/3, VKM nr. 231, datë 11.5.2000 "Për pranimin në shërbimin civil dhe periudhën e provës", pika 7, ndryshuar me VKM nr. 196, datë 6.4.2001, pika 1, Autoriteti i Konkurrencës shpall konkursin për tre vende të lira pune në pozicionet:

*Pergjegjes i Sektorit te Pozites Dominuese*

*Pergjegjes i Sektorit Anti –Kartel*

*Pergjegjes i Sekotrit te Perqendrimeve*

Kandidati duhet të plotësojë **kërkesat e përgjithshme** në përputhje me nenin 12 të ligjit nr.8549 dt.11.11.1999 "Statusi i nëpunësit civil".

**Kërkesa të veçanta për kandidatin**

- Të jetë diplomuar në Fakultetin e Ekonomisë
- Vjetërsia në pune 3 vjet, përvoja në administratën publike përben avantazh.
- Të zotërojë aftësi të mira drejtuese, menaxhuese, raportuese
- Të zotërojë gjuhën angleze, një gjuhë e dytë përben avantazh
- Të ketë aftësi të mira organizuese, komunikuese dhe të punës në grup.
- Të përdorë programet bazë të kompjuterit

**Përshkrimi i punës:**

Studimi dhe hetimi i tregjeve kur shfaqen praktikant antikonkurrese, si abuzimit me pozitën dominuese në treg, marrëveshjet e ndaluara dhe përqendrimet që krijojnë ose forcojnë pozitën dominuese pas bashkimi/përqendrimit në përputhje me praktikant evropiane në këtë fushë.

Analizimi i kushteve të tregut për sektorët me të rëndësishëm të ekonomisë që paraqesin praktikant jo konkurruese si pasoje e abuzimit potencial me fuqinë e tregut të një ose disa ndermarrjeve.

Identifikimi i praktikave të marrëveshjeve të ndaluara sipas përcaktimit të ligjit, si në formën e marrëveshjeve horizontale apo vertikale që kanë për qëllim shtremberimin, kufizimin ose deformimin e konkurrencës në treg.

**Paraqitja e dokumentave**

Kandidati duhet të paraqesë brenda datës **23.06.2007** në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore Shërbimeve dhe Dokumentacionit, me adresë; Autoriteti i Konkurrencës, Rruga Sami Frashri nr4, kati IV; këto dokumenta:

- Kërkesën për aplikim.
- Curriculum Vitae
- Çertifikatë personale me foto dhe përbërje familjare.
- Fotokopje të diplomës dhe listës së notave të noterizuara.
- Çertifikata kualifikimi (në rast se ka).
- Vlerësim pune nga punëdhënësi i fundit.
- Fotokopje të librezës së punës dhe librezës së kontributeve.
- Dëshmi e gjendjes gjyqësore dhe mjeksore.

Studentët që kanë kryer studimet jashtë shtetit duhet të kenë bërë **njohjen** e diplomave apo çertifikatave.

Dokumentet duhen të paraqiten vetëm në gjuhën shqipe.

**Konkurimi:** Eshtë i hapur për nëpunësit civil të të njëjtës klasë me procedurat e lëvizjes paralele, si dhe për kandidatët jashtë administratës publike sipas procedurave të pranimit në shërbimin civil.

Pas verifikimit paraprak të dokumentave në datën 25.06.007, në zyrat e Autoritetit të Konkurrencës do të shpallet lista e konkurrenteve që do të vazhdojnë më tej konkurimin si dhe data kur do të zhvillohet testimi me shkrim dhe intervista me gojë.

***Fushat e testimit:***

Konkurimi do të bazohet në njohjen e ligjshmërisë në fuqi, kryesisht ligjin nr. 9121, datë 28.07.2003 " Për Mbrojtjen e Konkurrencës" dhe akteve nën ligjore në zbatim të tij, njohuri mbi Politikën Kombëtare të Konkurrencës, mbi legjislacionin European në Fushën e Konkurrencës, njohuritë për Kushtetutën, Kodin e Procedurave Administrative, ligjin nr.8549, datë 11.11.1999 "Statusi i nëpunësit civil", ligjin nr. 9131 datë 8.9.2003 "Për rregullat e etikës në administratën publike.

***Për më shumë: [www.caa.gov.al](http://www.caa.gov.al)***